

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Liria ka Emër" thërret marsh më 1 tetor, inicion peticion qytetar
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/liria-ka-emer-therret-marsh-me-1-tetor-inicion-peticion-qytetar-1
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:14:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 12:28:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fe2e2ff8257dcc2bcbe80541828f18bedcf1fcd1acf22c602e5eca5a802e5670
TEKSTI	de6aa8f1cdee0bafab444c91a212fd868c33ecfc89e58a286a367206348461ae
PAMJA	215b755874c2b6b4247864f00c91214d0b9cd9f3f4ab812a5dc59d3e9561cd2b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	87ae5e66145fad156556c52f537342f7931496860db64f6037d2a55444b085da
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/87ae5e66145fad156556c52f537342f7931496860db64f6037d2a55444b085da>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën [Kontribuo →](#) [Letër lexuesit](#)

ARBËRI

“Liria ka Emër” thërret marsh më 1 tetor, inicion peticion qytetar



22 shtator 2026 14:28

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalim tonë zyrtar në Viber

Platforma “Liria ka emër” ka ftuar për marsh më 1 tetor në Prishtinë, në mbështetje të katër udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që javën e shkuar u dënuan me 81 vjet burgim për krime lufte. Kjo platformë ka bërë të ditur po ashtu se do të iniciohet një peticion qytetar për ta dërguar simbolikisht në Bruksel, Strasburg e Hagë, si shprehje e qëndrimit qytetar. Të dyja do të bëhen nën moton “Jo në emrin tim”.

Në një konferencë për shtyp, përfaqësues të kësaj platforme kanë kërkuar angazhim dhe koordinim të institucioneve të Kosovës, pas shpalljes së aktgjyqimit dënues për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin nga Gjykata Speciale në Hagë, më 16 shtator.

Përfaqësuesi i kësaj platforme, Ismail Tasholli i ka bërë thirrje spektrit politik, diplomatëve, shoqërisë civile, ekspertëve dhe mërgatës të bëhen pjesë e një përpjekjeje të koordinuar lidhur me këtë proces.

“Sot nuk jemi këtu për pushtet e opozitë. Nuk jemi këtu për të hapur betejat e djeshme politike. Sot duhet të jemi bashkë. Përpara nesh është një proces vendimtar dhe një fazë e re juridike. Prandaj kërkojmë që institucionet e Republikës së Kosovës të veprojnë me përgjegjësi, koordinim dhe transparencë. Qeveria duhet të na tregojë qartë: Cili është plani? Cila është strategjia shtetërore? Çfarë mbështetje juridike dhe financiare do të ofrohet? Çfarë do të bëjë diplomacia e Kosovës? Si do të angazhohen institucionet akademike dhe ekspertët ndërkombëtarë?”, ka thënë ai.

Tasholli ka bërë thirrje edhe për një mbledhje urgjente të përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe të Shqipërisë.

“Me një pikë të rendit të ditës, mbështetjen institucionale për mbrojtjen e luftës së UÇK-së dhe sigurimin e financimit të nevojshëm për mbrojtjen juridike. Sepse, në këto momente nuk duhet të ketë Prishtinë e Tiranë që shikojnë larg njëra-tjetrën. Duhet të ketë një tavolinë, një koordinim dhe një përgjegjësi të përbashkët institucionale”, ka thënë ai.

Arbëri.

Kallas takon Kurtin e Vuçiqin: Koha për të ecur përpara

Arbëri.

Haradinaj: Këto protesta kaq të qeta po më frikësojnë, revolta po mbledhet

Arbëri.

Haradinaj: Behajdin Allaqi u përmend për të krijuar huti dhe përçarje

Kulturë.

Enver Petrovci – artisti që largohet nga jeta, por jo edhe nga skena

Arbëri.

Arrestohet në Maqedoninë e Veriut ish-luftëtar i UÇK-së, Fadil Pushkolli

Futboll.

Kosova vazhdon përgatitjet për duelin ndaj Irlandës



LAJMET E MBRËMJES • 9 o. më parë

“Liria ka Emër” thërret marsh më 1 tetor,
inicion petition qytetar

Ndërkaq, përfaqësuesja tjetër, Eliza Hoxha, ka thënë se 1 tetori
nuk është zgjedhur rastësisht si datë e marshit.

“Më 1 tetor 1997, studentët e Kosovës dolën në rrugë në një
protestë paqësore që mbeti një nga momentet simbolike të
rezistencës qytetare. Më 1 tetor, ne do të dalim përsëri paqësisht,
me një mesazh të përbashkët: JO NË EMRIN TIM. Më 10 tetor,
kjo thirrje do të vazhdojë në Bruksel, së bashku me mërgatën
tonë. Kosova brenda dhe Kosova jashtë do të flasin me një zë”,
ka thënë ajo.

Marshi pritet të mbahet me fillim prej orës 16:00.

Nga kjo platformë janë zotuar për aktivitete të vazhdueshme
qytetare, akademike dhe publike në Kosovë dhe jashtë saj.

Edhe



Arbëri • 18 sht 2026

“Jo në emrin tim”, mijëra qytetarë në
natën e tretë rresht kundërshtojnë
vendimin e Speciales

“Qeverisë i kërkojmë plan. Institucioneve u kërkojmë koordinim.
Partive politike u kërkojmë bashkëpunim. Mërgatës dhe
qytetarëve u bëjmë thirrje për pjesëmarrje qytetare. Sot nuk
kërkojmë që të gjithë të mendojnë njësoj. Kërkojmë që
institucionet të marrin përgjegjësitë e tyre dhe që dallimet
politike të mos e pengojnë koordinimin për çështjet që
konsiderohen me interes shtetëror”, ka thënë Hoxha.

Më 16 shtator, Gjykata Speciale dënoi Hashim Thaçin e Jakup
Krasniqin me nga 25 vjet burgim, Kadri Veselin me 18 e Rexhep
Selimin me 13. Nga ajo ditë vazhdimisht ka pasur protesta në
Prishtinë dhe diasporë në kundërshtim të vendimit.

#LIRIA KA EMER

#PROTESTE

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 17 sht 2026

“Jo në emrin tim” – Në Prishtinë
protestohet ndaj vendimit të Speciales



Arbëri • 12 sht 2026

“Liria ka Emër”: Në marsh morën pjesë
rreth 100 mijë qytetarë



Arbëri • 11 sht 2026

“Liria ka Emër” fton për pjesëmarrje në
marsh, Kurti e Abdixhiku s'i përgjigjen
ftesës për fjalim

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i pasautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL EN DE FR ES GR SR TR MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHES



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.